



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 1, datë 01. 03. 2012

**“PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK TË TIRANËS  
NR.25, DATË 28.12.2011, “PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2012”**

Në mbështetje të nenit 19, pika 9 dhe nenit 32, gërma “dh” të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000, për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); nenit 39 të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; ligjit nr.7776, datë 22.12.1993 për “Buxhetin lokal” (i ndryshuar), vendimit të Këshillit Bashkiak të Tiranës nr.25, datë 28.12.2012, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2012” dhe udhëzimit të Ministrit të Financave nr.2, datë 06.02.2012 për “Procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pas shqyrtimit të relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Të miratojë shtesë në pikën 1.1 të vendimit të Këshillit Bashkiak të Tiranës nr. 25, datë 28.12.2011, “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2012”, **për fondin e mbartur nga viti 2011**, sipas akt-rakordimeve me Degën e Thesarit të Tiranës në shumën 347.367.165 lekë, detajuar sipas pasqyrës nr.1, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Të miratojë shtesë në pikën 1.1 të vendimit të Këshillit Bashkiak të Tiranës nr.25, datë 28.12.2011, “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2012”, të fondit të mbartur nga viti 2011, për projektet e përfituara nga **Granti Konkurrues** në shumën 10.137.024 lekë, detajuar sipas pasqyrës nr.2, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit Strategjik, të kryejë sistemimet në buxhetin e vitit 2012 në të ardhurat dhe shpenzimet sipas pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi.
4. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit Strategjik, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Menaxhimit të Shërbimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Prokurimeve, Njësitë Bashkiake 1-11, Drejtoria e Përgjithshme Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit, Drejtoria e Përgjithshme Nr.2 e Punëtorëve të Qytetit, Drejtoria Nr.3 e Punëtorëve të Qytetit, Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve, Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme, Shkolla speciale "Luigj Gurakuqi" dhe Qendra Sociale “Shtëpia e Përbashkët”, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

**Niazi KOSOVRASTI**